



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 275/6 Prot.

Tiranë, më 20.06.2016

V E N D I M

Nr. 68, datë 20.06.2016

*“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,
filluar me Urdhrin nr. 275/1., datë 01.04.2016”*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në përfundim të procedurës së inspektimit,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit të verifikimit nr. 275/1., datë 01.04.2016, pas marrjes në shqyrtim të dokumentacionit që ndodhet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, u krye hetimi administrativ në lidhje me sistemimin e ***** , pas përfundimit të detyrës si “Ambasador”, në pozicionin analog në shërbimin civil.

Nga aktet e administruara ka rezultuar se, ***** , e ka filluar marrëdhënien e punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme me disa funksione politike, siç mund të përmendim: Këshilltar i Ministrit të Punëve të Jashtme (me aktin nr. 556, datë 30.09.2005); Koordinator i nismës së Paktit të Stabilitetit për vendet e Evropës Jug-Lindore (me aktin nr. 31, datë 18.01.2007); Drejtor i Kabinetit të Ministrit të Punëve të Jashtme (me aktin 235/1, datë 03.05.2007); Këshilltar i Ministrit të Punëve të Jashtme (me aktin nr. 412, datë 07.09.2007), etj.

Më tej, rezulton se ky punonjës ka vijuar të punojë në disa pozicione pune pjesë të shërbimit civil, e konkretisht: me aktin nr. 418, datë 13.09.2007, të Ministrit është emëruar Drejtor i Promovimit Ekonomik dhe Kulturor; me aktin nr. 62, datë 01.02.2010, të Ministrit është emëruar

Drejtor i Përgjithshëm i Bashkëpunimit Ekonomik dhe Zhvillimit dhe, së fundi, me aktin nr. 199, datë 07.06.2012, të Ministrit është emëruar Përgjegjës i Sektorit të Analizës Ekonomike dhe Promovimit në Drejtorinë e Diplomacisë Ekonomike.

Pozicionin e fundit në shërbimin civil si *“Përgjegjës i Sektorit të Analizës Ekonomike dhe Promovimit”*, në Drejtorinë e Diplomacisë Ekonomike, punonjësi në fjalë, e ka ushtruar deri në momentin kur është emëruar *“Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiptotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Turqisë, Republikën e Azerbajxhanit, rezident, si dhe Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiptotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën Islamike të Iranit, Republikën e Kirkistanit, Republikën Islamike të Pakistanit dhe në Republikën e Gjeorgjisë, jorezident”*, me dekretin nr. 7895, datë 27.12.2012 dhe dekretin nr. 7908, datë 30.12.2012, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, detyrë të cilën e ka përfunduar me dekretin nr. 9389, datë 06.01.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Në momentin e rikthimit, ky punonjës nuk është sistemuar si nëpunës civil ose si punonjës i shërbimit të jashtëm, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe kjo është arsyeja e lindjes së kësaj mosmarrëveshje, e cila është bërë objekt i këtij inspektimi administrativ.

Duke analizuar procedurën e ndjekur për emërimet e mësipërme, si në pozicione të shërbimit civil ashtu dhe të shërbimit të jashtëm (*Drejtor i Promovimit Ekonomik dhe Kulturor; Drejtor i Përgjithshëm i Bashkëpunimit Ekonomik dhe të Zhvillimit dhe Përgjegjës i Sektorit të Analizës Ekonomike dhe Promovimit në Drejtorinë e Diplomacisë Ekonomike*), konstatohet se në të gjitha rastet, ato janë kryer pa respektuar rregullat e pranimit në shërbimin civil, të parashikuara në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999, *“Statusi i nëpunësit civil”* dhe ato të pranimit në shërbimin e jashtëm, sipas përcaktimeve të pjesës së tretë, kreu I-rë, *“Statusi i nëpunësit të shërbimit të jashtëm”*, të ligjit nr. 9095, date 03.07.2003 *“Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”*, që ishin në fuqi në atë kohë.

Të gjitha aktet e sipërpërmendura janë nxjerrë në mbështetje të pikës 81, të Vendimit nr. 839, datë 17.12.2004, të Këshillit të Ministrave *“Rregullore e shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë”*, dispozitë e cila parashikonte shprehimisht që: *“Ministria e Punëve të Jashtme, për nevoja të institucionit, brenda dhe jashtë vendit, mund të marrë punonjës për të shërbyer në shërbimin e jashtëm, për aq kohë sa vlerësohet e nevojshme. Këta punonjës gëzojnë statusin e diplomatit për aq kohë sa janë në shërbimin e jashtëm, por nuk përfitojnë grada diplomatike. Ata paguhen në bazë të detyrës, për të cilën janë emëruar”*.

Nisur nga ky konstatim, arrihet në përfundimin se, punonjësi ***** , gjatë karrierës së tij në Ministrinë e Punëve të Jashtme, sipas legjislacionit të kohës, nuk ka përfitur në asnjë moment, statusin e nëpunësit civil dhe statusin e diplomatit të karrierës, sipas legjislacionit të kohës.

Statusin e diplomatit apo atë të nëpunësit të shërbimit të jashtëm, ai e ka gëzuar për aq kohë sa ka shërbyer në funksione pjesë të shërbimit të jashtëm (*sipas pikës 81, të Vendimit nr. 839, datë 17.12.2004, të Këshillit të Ministrave*) dhe në asnjë rast nuk është paraqitur si subjekt për t’u trajtuar me gradë diplomatike nga Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës, pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, për të marrë statusin e diplomatit.

Statusi i diplomatit, sipas përcaktimeve të nenit 39, të ligjit nr. 9095, date 03.07.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar, është kusht i nevojshëm për të përfituar nga të drejtat e nëpunësit të shërbimit të jashtëm, ku përfshihet edhe e drejta e përcaktuar në gjuhën “c”, të kësaj dispozite, që parashikon mundësinë për të marrë funksione në Ministrinë e Punëve të Jashtme (*pra, në shërbimin civil*), në përfundim të misioneve diplomatike, në përputhje me nivelin profesional dhe gradën që gëzon diplomati.

Fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014), punonjësin ***** e ka gjetur në detyrën e “Ambasadorit”, pozicionin e cili është funksion i lartë, në fushën e shërbimit të jashtëm. Funksioni i ambasadorit (*për një diplomat karriere*) ekuivalentohet me funksionin më të lartë në shërbimin civil, me atë të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJ, me kusht që funksionari të ketë bërë pjesë më parë në shërbimin civil dhe këtë gradë ta ketë marrë nga Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës në Ministrinë e Punëve të Jashtme, mbi bazën e zhvillimit të sistemit të karrierës në shërbimin e jashtëm.

Ky përfundim arrihet edhe nga analiza e pikës 1, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas të cilës, vetëm ata nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues në një institucion qendror (*siç është edhe MPJ*) të pranuar në shërbimin civil, sipas procedurave të ligjit nr. 8549, dt. 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” janë për shkak të ligjit, anëtarë të TND. Pra, siç del qartë nga përmbajtja e kësaj dispozite është kusht që, për të fituar statusin e anëtarit të TND-së, për shkak të ligjit të ri të nëpunësit civil, të jetë pranuar në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së konkurrimit.

Në rastin konkret, punonjësi ***** në asnjë moment nuk e ka fituar statusin e nëpunësit civil, por gjithë kohën ka qenë i punësuar me akte emërimi të ministrit, qoftë në pozicione të nivelit politik, ashtu dhe në pozicione të shërbimit civil. Emërimi në detyrën e ambasadorit, është bërë duke shfrytëzuar mundësinë që lejonte pika 81, e Vendimit nr. 839, datë 17.12.2004, të Këshillit të Ministrave “Rregullore e shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dispozitë kjo që përmban në vetvete dhe kufizimin “...Këta punonjës gëzojnë statusin e diplomatit për aq kohë sa janë në shërbimin e jashtëm, por nuk përfitojnë grada diplomatike...”(citim), gjendje e cila konfirmohet dhe nga pika 2 e nenit 3 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, sipas së cilës, mund të rregullohen me dispozita të posaçme elemente të marrëdhënieve të shërbimit civil në shërbimin e jashtëm (*neni 39, i ligjit nr. 9095, date 03.07.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”*).

Për më tepër, në nenin 3 pika 1, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, parashikohet se për nëpunësit e shërbimit të jashtëm zbatohet legjislacioni i shërbimit civil për aq sa nuk parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm. Në rastin konkret, ligji i posaçëm që rregullon shërbimin e jashtëm nuk parashikon ndonjë kusht tjetër, përveç atyre që u thanë më sipër.

Në analizë të gjithë sa u parashtruan deri tani, arrihet në përfundimin se pretendimi i punonjësit që ka vënë në lëvizje këtë proces administrativ, për njohjen nga ana e organeve kompetente të statusit të anëtarit të TND-së, pasi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ai ka qenë në detyrë në funksionin e ambasadorit, dhe duhej të

përfitonte nga mundësia që njeni 67, për t'u përfshirë për shkak të këtij ligji, në trupën e TND-së, nuk është i bazuar në ligj.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14, 15 dhe 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenet 115, pika “a”, 116 pika “c” dhe 117, pika 1, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative në R. SH”; nenin 34, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë të rastit të paraqitur nga ***** , në lidhje me sistemimin e tij, pas përfundimit të detyrës si “Ambasador”, në pozicionin e mëparshëm që ka pasur në Ministrinë e Punëve të Jashtme.
2. Të njoftohet për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe ***** .

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA